

# ALBANIAN COMPETITION AUTHORITY

## SHPREHJE

“Ndërmarrjet dominuese duhet të sigurojnë që biznesi i tyre të mos dëmtojë konsumatorin dhe inovacionin.”

Mario Monti,  
ish Kryeministër i Italisë,  
ish Kryetari i Komisionit të Konkurrencës.

## AUTORITETI I KONKURRENCËS

**Qëllimi i këtij newsletteri është t'u japë lexuesve një përmbledhje të punës së Autoritetit të Konkurrencës nëpërmjet vendimeve të Komisionit të Konkurrencës**

# COVID 2019

Nisur nga disa ankesa të paraqitura pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi rritjen e çmimit të materialeve paramjekësore, u krye një monitorim në këtë treg lidhur me tregtimin e materialeve: **dezinfektant duarsh, alkool dhe maska**, për të cilat kërkesa konsumatore ka qenë në rritje si pasojë e situatës së krijuar nga virusi COVID-19.

Komisioni i Konkurrencës me vendimet nr. 684 dhe 685, datë 18.03.2020, vendosi: "**Hapjen e hetimit paraprak në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore**", dhe "**Marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore**".



Nga verifikimi në terren u konstatua rritje e pajustificueshme e çmimit në të gjitha nivelet e tregtimit të këtyre materialeve.

Për rrjedhojë, nëpërmjet VKK nr. 717, datë 15.10.2020, Komisioni i Konkurrencës vendosi të gjobisë disa ndërmarrje për mos zbatimin e masës së përkohshme të VKK nr. 685.



Ndërmarrjet kanë vazhduar të rrisin në mënyrë të pajustificuar çmimet për produktet maska, alkool dhe xhel-dezinfektant dhe termometra.

Në këto kushte, Komisioni i Konkurrencës nëpërmjet VKK nr. 716, datë 15.10.2020 vendosi "**Hapjen procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të maskave, në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të alkooleve dhe xhel-dezinfektant, në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të termometrave**".



# VENDIMET KRYESORE

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 693, datë 14.05.2020, konstatoi:

**Abuzimin me pozitën dominuese nga ana e Federatës Shqiptare të Futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, si dhe i dha kushte dhe detyrime.**



Më datë 21.09.2020,  
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë  
Tiranë vendosi:


Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 693, datë 14.05.2020 "Për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të Federatës Shqiptare të Futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve", si vendim të bazuar në prova dhe në ligj.



**Në periudhën kohore 30 Janar – 11 Shkurt 2020, të tre operatorët celularë kanë hedhur në treg paketat e reja standarde 30 ditore me parapagesë me një rritje në çmim prej 200 lekësh, si dhe kanë rritur vlerën minimale për rimbushje me 100 lekë, nga 100 në 200 lekë.**

Me vendimet nr. 679 dhe 680, të datës 14.02.2020, u hap procedura e hetimit paraprak, dhe u vendos marrja e masës së përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun me pakicë të shërbimeve celulare.

Nga monitorimi i zbatimit të vendimit, vihet re se operatorët kanë ndërprerë aplikimin e paketave të reja standarde 30 ditore me parapagesë.



Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 703, datë 06.08.2020, miratoi angazhimet në formën e kushteve dhe detyrimeve të cilat kanë fokus:

- Transparencën ndaj konsumatorëve dhe institucioneve mbikëqyrëse;
- Paketa me çmime të përballueshme për përdoruesit me të ardhura më të ulëta;
- Ofrim i një kapaciteti më të madh të internet data në celular.



Komisioni i Konkurrencës rekomandoi IAL-të:

- të llogarisin koston për student për secilin program studimi,
- të bëjnë publike tarifat e studimit për çdo vit akademik,
- të bëjnë transparente mënyrën e përdorimit të fondeve duke e publikuar në faqet e tyre zyrtare,

IAL-të private detyrohen të ndajnë llogarinë ekonomike të tyre me NIPT të veçantë nga llogaria ekonomike e shoqërisë tregtare (SHPK/SHA) ose Fondacionit që e ka krijuar dhe e financon.



**Me vendimin nr. 706, datë 10.09.2020, Komisioni i Konkurrencës vendosi:**

Mbylljen e hetimit të përgjithshëm në Sektorin e Arsimit të Lartë; dhënien e disa rekomandimeve për MASR, INSTAT, IAL-të publike dhe private, si dhe dhënien e disa detyrimeve për IAL-të private."

# MONITORIME

## Vendim nr. 689, datë 24.04.2020

Për vazhdimin e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjes së lidhur midis shoqërive të sigurimit për kartonin jeshil.


**Ndërmarrjet pjesë të marrëveshjes do të monitorohen për një periudhë 2 (dy) vjeçare.**

Tregu i  
Sigurimeve  
për Kartonin  
Jeshil



## Vendim nr. 700, datë 24.07.2020

Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit ndaj ndërmarrjeve Agro Blend SHPK, Miell Tirana SHA, Bloja SHA, Atlas SHA dhe Atlas Mills SHPK, me kushte dhe detyrimeve dhe dhënien e disa rekomandimeve për MFE, MBZHR dhe AKU. **Ndërmarrjet do të monitorohen lidhur me mënyrën e zbatimit të këtij vendimi për një periudhë 1 (një) vjeçare.**



Tregu i importit të  
grurit, importit,  
prodhimit dhe  
tregtimit të miellit

## Vendim nr. 702, datë 30.07.2020

Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto dhe dhënien e disa detyrimeve dhe rekomandimeve për ndërmarrjen Bankers Petroleum Albania LTD, Albpetrol dhe AKBN.

**Bankers Petroleum Albania LTD do të monitorohet për një periudhë 1 (një) vjeçare.**

Tregu i  
prodhimit dhe  
tregtimit të  
naftës bruto



## Vendim nr. 723, datë 17.11.2020

Për mbylljen, me kushte dhe detyrime, procedurën e hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo.

**Ndërmarrjet to të monitorohen lidhur me mënyrën e zbatimit të këtij vendimi për një periudhë 1 (një) vjeçare.**




Tregu  
Bankar

## Hetim i Përgjithshëm

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 552, datë 04.10.2018 vendosi:

“Hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor”  
- Procedura është në proces.

Tregu i  
Shërbimeve  
Spitalore



## Vendosje gjobe - Durrës Container Terminal



Gjatë monitorimit u konstatua abuzimi i DCT SHA, me tarifat e shërbimit të ngarkim-shkarkimit.

Me anë të VKK nr. 696, datë 11.06.2020, u vendos gjobitja e ndërmarrjes “Durrës Container Terminal” SHA për abuzim me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve në Terminalin e Konteinerëve Durrës” si dhe u dha një rekomandim për MIE dhe MFE.

# AKTE - Udhëzime

Udhëzimi “Për fuqizimin e Autoritetit të Konkurrencës për të qenë sa më i efektshëm në zbatueshmërinë e Ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut”, është përshtatur duke u përafuar me Direktivën e Bashkimit Evropian 2019/1, dhe synon të adresojë aspekte shumë të rëndësishme të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës, që lidhen me të drejtën për të kryer hetime, për të vendosur sanksione administrative, për të ofruar siguri ligjore dhe garanci për ndërmarrjet nën hetim dhe palët e treta, për të garantuar zbatueshmërinë e Programit të Lehtësimit nga Gjohat, etj.

Udhëzimi “Për praktikat më të mira për kryerjen e procedurave në lidhje me zbatimin e nenit 4 dhe 9 të ligjit nr.9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar”, është përshtatur duke u përafuar me njoftimin e Komisionit Evropian 2011/C 308/06, dhe përcakton parimet mbi të cilat mbështetet veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës duke patur parasysh parimet e ligjshmërisë, transparencës, të drejtës së informimit, konfidencialitetit, drejtësisë, proporcionalitetit, paanësisë, objektivitetit, jodiskriminimit, të përcaktuara në ligjin nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative.

Udhëzimi "Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike", është përshtatur duke u përafuar me Direktivën e Komisionit Evropian 2002/77/ EC e 16 shtatorit 2002 “Mbi konkurrencën në tregjet e rrjeteve dhe shërbimeve për komunikimet elektronike”.





Memorandum Mirëkuptimi midis Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionit Kombëtar Spanjoll për Tregjet dhe Konkurrencën.

Në kuadër të projektit IPA të Bashkimit Evropian, *“Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve të Autoritetit të Konkurrencës për të mbrojtur Konkurrencën e lirë dhe efektive në treg”*, Autoriteti i Konkurrencës dhe Komisioni Kombëtar Spanjoll për Tregjet dhe Konkurrencën nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit më 23.11.2020 në Tiranë, Shqipëri dhe më 24.11.2020 në Madrid, Spanjë.




ECN+



## BASHKËPUNIME



# DITA NDËRKOMBËTARE E KONKURRENCËS



Më 5 Dhjetor, Autoriteti i Konkurrencës organizoi aktivitetin me titull:

**“Promovim publik nëpërmjet videoprojeksionit në godinën e Universitetit të Tiranës për Ditën Ndërkombëtare të Konkurrencës”**

Prezantimi përfshiu një përmbledhje të punës së institucionit gjatë vitit të kaluar.

5 Dhjetori është caktuar si Dita Ndërkombëtare e Konkurrencës, për shkak se në këtë datë, në vitin 1980, është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, “Seti shumëpalësh i parimeve dhe rregullave mbi kontrollin e praktikave kufizuese të biznesit”.

Autoriteti i Konkurrencës e vlerëson këtë datë si të rëndësishme për promovimin e kulturës së konkurrencës si dhe në sensibilizimin e aktorëve të tregut dhe palëve të interesit lidhur me avantazhet e një konkurrence të lirë dhe efektive në treg.



Është me vlerë që konsumatorët të njihen me konceptet e konkurrencës, pasi në këtë mënyrë mund t'i drejtohen Autoritetit të Konkurrencës lidhur me çështje të cilat janë objekt i ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

# PRIORITETET 2021

## 1

Autoriteti i Konkurrencës, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 9121/2003, për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, do të vazhdojë hetimet dhe monitorimet kryesisht në tregjet me impakt të drejtpërdrejtë në interesat dhe mirëqënien e konsumatorit:

- tregje të cilat konsiderohen si tradicionale:  
tregu i telekomunikacioneve, energjisë,  
hidrokarbureve, financiar dhe ai i sigurimeve;



- tregje të reja si: tregu farmaceutik dhe tregu spitalor.




## 2

Me qëllim adresimin në mënyrë të përshtatshme dhe domethënëse të çështjeve sensitive si dhe të trajtimit të ankesave, Autoriteti i Konkurrencës do të intensifikojë bashkëpunimin me Entet Rregullatore duke krijuar sinergji pozitive të cilat janë në dobi të palëve të interesit.



## 3

Në kuadër të implementimit të Strategjisë 5-vjeçare të Advokacisë, Autoriteti i Konkurrencës ka si synim zbatimin e Komponentëve të saj.



Me përfundimin e projektit të BERZH-it : “Promovimi i Advokacisë dhe Forcimi i Kapaciteteve Institucionale të Autoritetit të Konkurrencës”, AK do të fillojë zbatimin e Strategjisë së Advokacisë e cila ndahet në dy komponentë, të cilët synojnë:

**Komponenti 1:** rritjen e efektshmërisë së Advokacisë, në të cilin përfshihen objektiva specifike me një publik të synuar;

**Komponenti 2:** përmirësimi i frytshmërisë së Strategjisë së komunikimit me anë të mjeteve, kanaleve si dhe monitorimit të efektivitetit.



Si të kontaktoni Autoritetin e Konkurrencës?

Website: [www.caa.gov.al](http://www.caa.gov.al)

Email: [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", Nr. 4, Kati IV,  
Tiranë, 1004

E Hënë - E Enjte 08:00 - 16:30,

E Premte 08:00 - 14:00



Telephone: +355 4 2234  
+355 42234504, +355 42234497



@AutoritetiK



Autoriteti Konkurrencës